



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 45**

Datë: 28. 08. 2024 ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr.43 dhe 44 /2024**

**3. Aktivitetet e Zyrës**

- Raporti i Zyrës për aktivitetet zgjedhore: Deklarimi i mos pjesëmarrjes në zgjedhje dhe Deklarimi i koalicioneve parazgjedhore;

**4. Raport i Këshillave të KQZ**

#### **4.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Listës Preliminare të Votuesve;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrit të vendvotimeve dhe numrit maksimal të votuesve;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i teksteve për periudhën e regjistrimit për votim jashtë Kosovës,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i teksteve për periudhën e ndërrimit të QV-së dhe kundërshtimit të LV-së.
5. Shqyrtimi i përgjigjeve automatike në sistem elektronik për ndërrim të QV dhe regjistrim për votim jashtë Kosovës;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i memorandum mirëkuptimi në mes KQZ-së dhe ANP "Adem Jashari".
7. Kërkesë për angazhimin e U.D Zyrtarit Ekzekutiv të KKZ-së në komunën e Gjilanit dhe Malishevës në cilësinë e Kryesuesit të KKZ-së

#### **4.2. Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtari të kuvendit komunal në Glllogovc;

#### **5. Të ndryshme**

---

##### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**Kreshnik Radoniqi**, kryesues i takimit pasqyroi agjendën, duke i pyetur anëtarët nëse kanë ndonjë propozim, vërejtje etj.

**Arianit Elshani**, kërkoi largimin e pikës 6 ( Memorandum mirëkuptimi në mes KQZ-së dhe ANP "Adem Jashari", dhe pikën 7 ( A angazhimin e U.D Zyrtarit Ekzekutiv të KKZ-së në komunën e Gjilanit dhe Malishevës në cilësinë e Kryesuesit të KKZ-së ). E para, për shkak se është në procedurë, kurse pika tjetër të kalojë në një këshillë tjetër për shqyrtim dhe miratim...

Me këto ndryshime, me 8 vota për u miratua rendi i ditës. Në vazhdim, u miratuan procesverbalet nr.43 dhe 44 /2024, me vërejtjen që në procesverbalin nr. 43 të largohet emri i anëtares "Mufera Shinik" meqë e njëjta, nuk ishte prezentë në këtë mbledhje. Mu 6 vota për, dhe dy abstenime (Mufera Shinik dhe Sami Kurteshi ), u miratuan këto dy procesverbale.

##### **2.Aktivitetet e Zyrës**

**Raporti i Zyrës për aktivitetet zgjedhore: Deklarimi i mos pjesëmarrjes në zgjedhje dhe Deklarimi i koalicioneve parazgjedhore:**

**Besnik Buzhala**, drejtues i zyrës, tha se në lidhje me deklarinimin e partive politike për koalicionet dhe për mos pjesëmarrje në zgjedhje, afati ka filluar më 16 gusht, përfundon më 30 gusht. Deri tani, dy parti kanë dorëzuar deklarinimet: një për koalicion, dhe një për mos pjesëmarrje në zgjedhje. Dje, kemi pranuar edhe një deklarinim: Lëvizja për "Bashkim" ka deklaruar se nuk merr pjesë në zgjedhje...

### **3. Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në Glllogvc:

**Sami Hamiti**, kryesues i këtij këshilli tha se është shqyrtuar kërkesa për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në komunën e Glllogvcit. Është shqyrtuar materiali, në fakt kërkesa dhe kemi pa se janë plotësuar të gjitha kushtet që Selman Collapeku të emërohet anëtarit të kuvendit nga Lëvizja "Vetëvendosje!", në zëvendësim të anëtarit të deritashëm Drin Halilaj.

Me 8 vota për miratohet ky zëvendësim.

### **4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

**Kreshnik Radoniqi**: Kemi diskutuar dhe kemi analizuar në takim rreth një memorandumi. Propozojmë që drejtori, në këtë rast Burim Ahmetaj të nënshkruaj memorandumin e mirëkuptimit në mes KQZ-së dhe Aeroportit "Adem Jashari".

Me 8 vota për, miratohet ky autorizim për nënshkrim të memorandumit.

### **4. Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Listës Preliminare të Votuesve:

**Arianit Elshani**, tha se këshilli e ka shqyrtuar raportin e Listës Preliminare të Votuesve. Kjo listë është marrë nga dy departamentet: e prodhimit të dokumenteve dhe gjendjes civile. Rezulton se lista ka 2, 47, 148, 00 votues. Lista është preliminare, dhe do të ju nënshtrohen edhe korrigjimeve të tjera. Kemi 116, 000 votues të rinj, ndërsa 46 512 janë votues që për herë të parë regjistruhen. Ndërsa, 47, 365 shtetas janë votues jashtë Kosovës.

Rekomandojmë që lista të votohet.

Anëtarët e KQZ me 8 vota për e miratuan Listën Preliminare të Votueseve.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrit të vendvotimeve dhe numrit maksimal të votuesve:

**Arianit Elshani**, tha se kjo pikë nuk është miratuar në KOZ. Nesër, do duhej të fillonte procesi por, duket që është e pamundur. Ne, bazuar edhe në ligjin e ri, tha z. Elshani, kemi marrë shumë veprime, debate, zgjidhjen e çështjes së serverit, takimet me ministrinë e jashtme, hartimin e rregullore etj. Mirëpo, me gjithë kërkesat, debatet, bashkëpunimin mendoj që nuk kemi një "listë" të Qendrave të Votimit. Ministria është vonuar, unë vetëm para dy ditësh kam pranuar një listë, edhe dje mirëpo nuk kemi një konfirmim specifik. Tash në këto momente kur filloi mbledhja, kemi pranuar një miell me një "listë – tabelë", mirëpo nuk jemi të qartësuar dhe nuk jemi të njoftuar si, e qysh...

Ka një proces, si definohet lista në përfaqësi diplomatike, numri i votuesve...! Është ligji zgjedhor, rregullorja si bëhet kjo. Por MPJ nuk është treguar aktive, dhe mendoj që ne edhe njëherë duhet të ulemi me MPJ-në dhe t'i bashkërendojmë aktivitetet...

Konsideroj që kjo pikë të tërhiqet, të shqyrtohet edhe njëherë dhe pastaj të silllet për miratim.

**Sami Kurteshi**, pyeti se cili është thelbi i çështjes, ku qëndron problemi...?

**Arianit Elshani** tha se, ne kemi kërkuar një konfirmim nga MPJ për një draft listë që e kemi punuar bashkë me dy zyrtarë e tyre. Numri maksimal në listën votuese, dhe e QV në përfaqësi diplomatike vendoset nga KQZ .Kuptohet, në koordinim. Ne, nuk kemi pranuar një miratim, as pajtim për numrin e votuesve, për qendrat e votimit. Dhe ne, pak para mbledhjes pranojmë një listë të ndryshuar, të prekur nga ata. Pa dashtë me e shndërrua në debat...

**Sami Hamiti**: Jemi në situatë kur nuk mund të vendosim. Takohemi dhe marrim në qëndrim në bazë të ligjit. Nesër, nuk mund të hapen dhe se shifrat, shkresa që ka ardhur, si mund të votojnë 10 mijë vetë në një përfaqësi...

**Ilir Gashi**, tha se ka një vit që ligji i ri ka hy në fuqi. Dhe ne, nuk kemi një gjendje që ti përgjigjemi kësaj sfide. Është shqetësues fakti që ne kemi një dokument ku MPJ bënë ndërhyrje. Ata, nuk e kanë të drejtën se çka të bëjmë ne, sa votues duhet të jenë në një VV, se a mundemi apo nuk mundemi të hapim qendra alternative...?

MPJ është dashur tash e një vit të punohet nga MPJ, por as ne se kemi vizituar as edhe një konsullatë për këtë çështje. Në shkresën e saj, MPJ sjellë “përvoja” të një vendi të tretë se si bëhet kjo...! Ministria, këto të dhëna i ka marrë në google. Ky dokument, është në shpërputhje me mundësitë dhe kushtet, pra nuk ka qasje serioze trajtimi... Realisht, kjo duket si mohim i kushteve për votim nga MPJ. Qasja, është jo serioze dhe, jo profesionale...

**Sami Kurteshi**, tha se janë probleme administrative, teknike dhe se shumë njerëz, as ata atje, nuk e dinë sa vtë mund të votojnë...! Mendoj se, mund të ketë probleme, mos kuptime, mos njohuri por nuk mendoj se kanë qëllim dikujt me ja mohue të drejtën e votimit. Mendoj që duhet ti takojmë, t’u shpjegojmë gjërat, kushtet, procedurat etj. Nuk mund të votojnë 10 mijë veta. Nuk munden. Ne e kemi një shifër, me rregull janë 750 votues, në mënyrë të jashtëzakonshme deri 900 votues...

**Ibrahim Selmanaj**, tha se ne jemi në afate të parapra. Ka munguar edhe komunikimi i brendshëm, përgjegjësia. Nuk kemi asgjë konkrete, sado që rrugët ligjore janë. Mendoj se, me panik nuk duhet të shkojmë sepse, qysh nesër në platformë rrjedh afati...Ne, duhet ta rrisim komunikimin me faktorët e tjerë...

Krehshnik Radoniqi: Këtë pikë, nuk do ta votojmë, të komunikojmë me MPJ dhe ti sqarojmë çështjet, dhe do të bëjmë zgjedhjen...

**Arianit Elshani**: Ka këtu probleme, është ditur afati, koha, dekreti i presidentes për zgjedhje...! Kemi dhënë mbështetjen maksimale, cod shpjegim. Kemi diskutua me detaje me zyrtarët e MPJ. Por, procesi është i qartë, dihet mënyra e votimit. Nuk mundesh me i kalue më shumë persona se 750, duhen dy – tre minuta, ka procedura, verifikime...

3.Shqyrtimi dhe miratimi i teksteve për periudhën e regjistrimit për votim jashtë Kosovës; Shqyrtimi dhe miratimi i teksteve për periudhën e ndërrimit të QV-së dhe kundërshtimit të LV-së:

**Arianit Elshani**, tha se i kemi shqyrtuar tekstet. Janë në imella tuaj, janë dhënë edhe komente si ai i z. Kurteshi. Dhe ne, rekomandojmë për miratim. Ashtu, si edhe për pikën 4.

**Sami Kurteshi**, propozoi të hiqet fjala ‘anulim’ në tekste dhe, në vend të saj të përdoret shprehja ‘refuzim’...

Kreshnik Radoniqi: Me këtë vërejtje të z. Kurteshi, të dy pikat i hedh në votim. Kush është për...?

Me 6 vota për, miratohen...

4. Shqyrtimi i përgjigjeve automatike në sistem elektronik për ndërrim të QV dhe regjistrim për votim jashtë Kosovës:

**Arianit Elshani**, tha se e kemi shqyrtuar edhe këtë pikë në KOZ, Nuk kemi pasur komente, kundërshtime. Prandaj, rekomandojmë për miratim...

**Të ndryshme!**